



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 20, datë 17. 07. 2009

PËR

“DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR PËRBALLIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NGA ZJARRI NË BANESËN E QYTETARIT Z. HAMDË MUKA, BANOR I NJËSISË BASHKIAKE NR.11, TIRANË”.

Në mbështetje të nenit 10, pika 3, paragrafi IV, germa “b” të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 2, pika 3 dhe nenit 16 të ligjit nr.8756, datë 26.03.2001 për “Emergjencat civile”; të Vendimit të Këshillit Ministrave nr.206, datë 26.03.1998 për “Kriteret e pjesmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatëkeqësish” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.1, datë 03.02.2009 për “Miratimin në parim të programit buxhetor afatmesëm për vitet 2009-2011 dhe miratimin e detajimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2009”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S I:

1. Ti akordojë një ndihmë financiare prej 40.000 (dyzetë mijë) lekësh, familjes së Z.Hamdi Muka, të cilit i është dëmtuar banesa dhe orenditë shtëpiake nga zjarri.
2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi, të përballohen duke pakësuar fondin rezervë në shumën 40.000 (dyzetë mijë) lek.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Financë Administratës, Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë pranë Bashkisë së Tiranës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Sokol DERVISHAJ

K R Y E T A R I